



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

Nr. 1002/11 Prot.,

Tiranë, më 31/03 /2021

U R D H Ë R

Nr. 16, datë 31.03.21

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE”**

Në mbështetje të VKM-së me nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar; si dhe nenit 5 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën për informim”

Me qëllim zbatimin me korrektësi të legjislacionit të mësipërm

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas përmbajtjes së miratuar me Urdhërin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.
2. Programi i Transparencës i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave publikohet në faqen zyrtare www.dogana.gov.al.
3. Ngarkohen të gjitha Drejtoritë dhe Koordinatori për të drejtën për informim për të bashkërenduar punën për bërjen publike sa herë që është e domosdoshme të çdo dokumenti në funksion të programit të transparencës së rishikuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gentë GAZHELI

